

L I G J
Nr.7504, datë 30.7.1991

PËR POLICINË E RENDIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Policia e rendit është organ ekzekutiv i armatosur, pjesë përbërëse e Ministrisë së Rendit Publik, në strukturën e Forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë

Neni 2

Veprimtaria e policisë së rendit bazohet në Kushtetute e në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe i përmbahet parimit të ligjshmërisë, të humanizmit e të objektivitetit.

Neni 3

Policia e rendit ka për detyrë të ruaje rendin publik, të parandalojë e zbulojë veprimtarinë kriminale që cënon të drejtat e ligjshme të individëve dhe të mbrojë pronën shtetërore e private dhe interesat e organizatave ekonomike, politike e shoqërore nga veprimet e kundërligjshme.

Neni 4

Policia e rendit, në kryerjen e detyrave të saj, mbështetet edhe në ndihmën e organeve shtetërore, të institucioneve, organizatave të ndryshme dhe të shtetasve.

Neni 5

Veprimtaria e policisë së rendit, si rregull është e hapur për opinionin publik dhe mjetet e informimit masiv. Ajo jep informacion për gjendjen e kriminalitetit e të rendit publik në përputhje me ligjin duke ruajtur sekretin shtetëror dhe nderin e dinjitetit e shtetasve.

Neni 6

Policia e rendit, si organ i depolitizuar, e organizon dhe zhvillon veprimtarinë e saj jashtë ndikimeve të partive politike dhe të organizatave shoqërore.

Në policinë e rendit ndalohen krijimi i sindikatave, grevat dhe moszbatimi kolektiv i urdhërit.

Neni 7

Punonjësi i policisë së rendit gëzon mbrojtje të veçantë sipas ligjit "Për statusin e ushtarakut". Ai është person i paprekshëm.

KREU II ORGANIZIMI I POLICISË SË RENDIT

Neni 8

Policia e rendit ndërtohet sipas ndarjes administrative tokësore të Republikës së Shqipërisë. Forcat përbërëse të saj përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Organet e policisë së rendit janë: Drejtoria e Policisë së Rendit në Ministrinë e Rendit Publik dhe policia e rendit në rreth.

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë emerohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 9

Ministri i Rendit Publik për veprimtari specifike, krijon struktura dhe shërbime të veçanta të policisë së rendit, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 10

Policia e Rendit në rreth, e cila është pjesë përbërëse e degës së Rendit Publik, varet nga Ministri i Rendit Publik dhe nga organet lokale të pushtetit për detyrat e ngarkuara me ligj.

Neni 11

Drejtorja e policisë së Rendit në Ministrinë e Rendit Publik drejton duke kontrolluar veprimtarinë dhe zbatimin e ligjshmërisë si dhe i jep ndihmë të kualifikuar tekniko-profesionale policisë së rendit në rrethe.

Neni 12

Punonjësit e policisë së rendit pajisjen me dokumentin zyrtar të identitetit, të cilin e paraqesin gjatë kryerjes së shërbimit. Ata kanë shenjë dalluese të personit (numër) për tu identifikuar. Detyrat për sigurimin e rendit i kryejnë me uniforme dhe shenja të caktuara nga Këshilli i Ministrave, të cilat nuk lejohet të përdoren nga individë dhe organe të tjera. Kur shërbimin e kryejnë me veshje civile, ata janë të detyruar të vërtetojnë qënien e tyre si punonjës të policisë.

Neni 13

Punonjësit e policisë së rendit pajisen me armë e mjete të tjera, të nevojshme për kryerjen e detyrës sipas rregullave të përcaktuara nga ministri i Rendit Publik.

KREU III DETYRAT E POLICISË SË RENDIT

Neni 14

Policia e rendit ka këto detyra:

1. organizon punën për ruajtjen e rendit publik në përputhje me dispozitat ligjore;
2. mbron jetën, shëndetin dhe dinjitetin e personit nga çdo veprim i paligjshëm;
3. siguron rregullin dhe u vjen në ndihmë shtetasve në rast aksidentesh e fatkeqësish natyrore;
4. kontrollon dhe kërkon nga personat juridikë a fizikë zbatimin e dispozitave ligjore kur këto dispozita ngarkojnë me detyra policinë e rendit;
5. mbron pronën shtetërore dhe private nga çdo veprim i kundërligjshëm;
6. siguron rendin gjatë zhvillimit të veprimtarive politike, shoqërore, kulturore, fetare, sportive e veprimtari të tjera të kësaj natyre. Nëse shkelen kërkesat e ligjit, merr masa për rivendosjen e rendit;
7. kontrollon e merr masa për zbatimin e dispozitave ligjore e të akteve të tjera që rregullojnë

qarkullimin e automjeteve e të këmbësorëve;

8. kontrollon e merr masa për zbatimin e legjislacionit në fushën e shërbimit të mbrojtjes nga zjari. në rast zjarresh organizon punën për shuarjen e tyre, duke bashkëpunuar me ushtrinë e me persona fizikë e juridikë.

9. lëshon leje për mbajtjen e armëve, të lëndëve plasëse dhe helmuese me efekt të fortë, për rastet kur përdoret droga për nevoja kurative mjekësore dhe për veprime të tjera të parashikuara me ligj, si dhe kontrollon zbatimin e rregullave të vendosura për administrimin, ruajtjen e përdorimin e tyre.

10. Zbaton vendimet e gjykatës, aktet e prokurorisë e të hetuesisë për kërkimin, gjetjen dhe sjelljen me force të personave, që ndiqen penalisht dhe nuk paraqiten ose i shmangen vuajtjes së dënimit.

11. Ekzekuton vendimet e gjykatës për dënimet penale dhe merr masa për sigurimin e transportimin e personave të ndaluar e të arrestuar.

12. Organizon kërkimin e kapjen e personave që i shmangen thirrjes së degës ushtarake për mobilizim dhe kërkesave të organeve të Drejtësisë e të Shërbimit Informativ Kombëtar. Shpall kërkimin e personave që janë deklaruar të pagjetur.

13. Kontrollon zbatimin e rregullave të caktuar në dispozita të veçanta për përgatitjen, përdorimin dhe ruajtjen e vulave zyrtare.

14. Pranon e mban në ruajtje, sipas afateve të caktuara, dokumentat e sende të gjetura dhe merr masa për tu kthyer pronarëve të tyre.

15. Zbaton detyrat që rrjedhin nga legjislacioni procedural penal e civil.

16. Mban evidence për sistemimin dhe klasifikimin e informacionit për ngjarje e persona në lidhje me krimet e kryera. Ministri i Rendit Publik përcakton rregullat, tipet e kërkesat e evidencës.

17. Përdor metoda shkencore e mjete tekniko-kriminalistike për parandalimin e zbulimin e krimeve dhe ruajtjen e rendit pa shkelur të drejtat e njeriut.

18. Merr masa për parandalimin e futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të mbeturinave toksike e radioaktive, të lëndëve narkotike, të drogës, si dhe ndjek personat që merren me trafikun e përdorimin e tyre.

Zbulon veprimtarinë e elementëve terroristë e të trafikantëve të armëve.

19. Organizon kërkimin dhe kapjen e personave që grabisin e tregtojnë objekte muzeale dhe vepra arti me vlerë kombëtare.

20. Kryhen detyra që i cakton me ligj në kuadrin e masave të mbrojtjes civile shtetërore.

Neni 15

Organet operative të policisë ndërtojnë punën operative gjurmuese për ndjekjen e veprimtarisë kriminale në përputhje me ligjin.

Neni 16

Policia e rendit detyrohet t'u japë ndihmë kur e kërkojnë:

- gjykatave, prokurorivë e hetuesive;
- deputetëve dhe personave të tjera me imunitet;
- organeve të shëndetësisë për sjellje me forcë për kurim ose kontroll të detyruar për sëmundje që paraqesin rrezikshmeri shoqërore;
- institucioneve arsimore, shëndetësore e fetare;
- organeve shtetërore të mbrojtjes së mjedisit;
- familjarëve e të afërmëve për kërkimin e personave të pagjetur;
- personave fizikë e juridikë kur u rrezikohet jeta ose pasuria;
- organeve të pushtetit lokal për zbatimin e ligjeve e të vendimeve.

Neni 17

Punonjësit e policisë së rendit i ushtrojnë detyrat e ngarkuara nga ligji në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ata i kryejnë detyrat edhe kur u rrezikohet jeta.

Neni 18

Policia e rendit, për kryerjen e detyrave bashkëpunon me policinë e fushave të tjera, veprimtaria e të cilave rregullohet me ligj. Bashkëpunimi ndërmjet policive rregullohet me akte të përbashkëta të ministrive përkatëse.

Policia e rendit bashkëpunon me policinë e vendeve të tjera dhe organizma të ndryshëm ndërkombëtar, në bazë të marrëveshjeve të arritura me to.

Neni 19

Detyrat funksionale sipas strukturës së shërbimeve të policisë së rendit caktohen nga ministri i Rendit Publik.

KREU IV TË DREJTAT E POLICISË SË RENDIT

Neni 20

Për kryerjen e detyrave të ngutshme të shërbimit, punonjësit e policisë së rendit përdorin mjetet e transportit e të nderlidhjes (me përjashtim të mjeteve të trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë) të personave fizikë e juridikë.

Për përdorimin e mjeteve të nderlidhjes ose të transportit lëshohet nga policia vërtetim kundrejt të cilit personit fizik e juridik, nëse e kërkon, i kthehet vlera në të holla e shpenzimit të kryer.

Neni 21

Punonjësitë e policisë së rendit në kushtet e flagrancës hyjnë në banesat e shtetasve, në mjedise të tjera të tyre dhe në zyrat e personave juridikë vetëm:

- për të parandaluar vepra penale;
- për kapjen e autorëve që fshihen;
- për sigurimin e provave;

për të dhënë ndihmën e nevojshme në rast aksidentesh, zjarresh e fatkeqësish natyrore, si dhe kur kërkohet ndihmë nga vetë shtetësit dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj.

Punonjësit e policisë së rendit, me pëlqimin e personelit, hyjnë në përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë për të parandaluar kryerjen një veprë penale.

Neni 22

Punonjësit e policisë së rendit sipas kompetencave të caktuara në ligj bllokojnë pjesë të rrugëve, banesa, zyra e mjedise të tjera, ku kanë ndodhur vepra penale dhe sigurojnë të paprekur vendin e ngjarjes e provat deri në ardhjen në vend të organeve të hetuesise. Ata kërkojnë dhe marrin nga personat juridikë, edhe nga shtetasit sende, dokumente e mostra për sqarimin e çështjes.

Neni 23

Punonjësit e policisë së rendit bëjnë kontrolle, bllokime sendesh e ndalime të shtetasve kundrejt dokumentacionit përkatës, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale në qoftese se ndalimi zgjat me shume se 6 orë ose kërkohet nga personi i ndaluar, njoftohet familja e një personi tjetër që e përcakton i ndaluar.

Personi që ndalohet në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e demit material nga organi që e ka ndaluar.

Neni 24

Punonjësit e policisë së rendit kanë të drejtë të thërrasin shtetasit për verifikime të ndryshme që lidhen me vepra penale e shkelje administrative dhe për vendosjen ndaj tyre të masave të parashikuara nga ligji.

Thirrja bëhet në lokalet e policisë a në zyra të tjera në anë të fletëthirrjeve ose në mënyrë verbale. Nëse shtetasit pas njoftimit me shkrim të shefit të policisë, refuzojnë pa arsye, sillen forcërisht.

Neni 25

Punonjësit e policisë së rendit kërkojnë prej individëve të paraqesin dokumentet identifikues në rastet kur kanë ndodhur vepra penale, kur dyshohet për veprimtari të kundërligjshme, kur shtetasi është kundërvajtës, si dhe kur bëhet kontroll i përgjithshëm në vende e mjedise të caktuara.

Të drejtën e kontrollit të dokumenteve të identifikimit e kanë edhe punonjësit ushtarak të sistemit të Ministrisë së Rendit Publik.

Neni 26

Punonjësit e policisë së rendit kanë të drejtë të kontrollojnë vetëm ata persona që nuk janë në gjendje të provojnë identitetin e tyre. Ata urdhërojnë shtetasit, që nuk kanë letërnjoftim, të pajisen me të brenda një datë të caktuar.

Neni 27

Punonjësit e policisë së rendit shoqërojnë për në rajonë, posta, nënreparte të policisë ose zyra të tjera të tyre, personat të cilët:

- shkelin rendin publik dhe nuk i ndërpresin veprimet edhe pas paralajmerimit të bërë;
- refuzojnë të paraqesin dokumentat e identiteti;
- nuk paraqiten në polici, kur kërkohen rregullisht në bazë të nenit 24 të këtij ligji;
- kundërshtojnë dhe pengojnë punonjësit e policisë në kryerjen e detyrave;
- janë gjendur në vendin e ngjarjes dhe dyshohet se janë autorë të veprave penale ;
- kërkohen nga organet kompetente .

Personave të shoqëruar u krijohen kushte normale dhe, pas sqarimit të rrethanave të çështjes për të cilën janë shoqëruar, lirohen menjëherë. Ata nuk mund të mbahen më tepër se 12 orë. Për veprimet e kryera, punonjësi i policisë të njoftojë menjëherë eprorin e tij direkt dhe ti pasqyrojë në dokumentacionin përkatës.

Neni 28

Policia e rendit kërkon ndihmë nga organet e specializuara për kryerjen e kontroll revizionit, sipas rregullave të përcaktuara në dispozita të veçanta.

Neni 29

Policia e rendit kërkon ndihmën e mjeteve të informacionit masiv për parandalimin e shkeljeve të ligjit, për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, si dhe për kërkimin e kapjen e personave të larguar në drejtime të paditura.

Neni 30

Punonjësit e policisë së rendit kanë të drejtë të përdorin forcën dhe mjetet e tjera në mënyrë të shkallëzuar, kur janë kushtet e përcaktuara me ligj.

Ndalohet kategorikisht përdorimi i torturës, çdo presion fizik e psikologjik si dhe çdo veprim tjetër antinjerëzor e poshtërues për dinjitetin e njeriut.

Neni 31

Punonjësit e policisë së rendit e përdorin forcën veç rasteve të parashikuara nga neni 27 i ligjit edhe :

- ndaj shtetasve që orvaten të lirojnë personat e shoqëruar a të ndaluar nga punonjësit e policisë së rendit;
- kur të ndaluarit ose persona të tjera që shoqërohen për në organe a mjedise të tjera, orvaten të largohen ose të vetëvriten ;
- Për të rivendosur rendin juridik të cenuar rende nga veprime të pakontrolluara të invidëve ose të grupeve të njerëzve.

Neni 32

Punonjësit e policisë së rendit, për përpmbushjen e detyrave, veç përdorimit të forcës, përdorin edhe mjete e pajisje të tjera të dhëna në përdorim këto përdoren pas paralajmërimit dhe ndërpriten së përdoruri menjëherë pas arritjes së qëllimit.

Ministri i Rendit Publik përcakton rregullat e mjetet si dhe mënyrën e kriteret e përdorimit të tyre.

Neni 33

Për kryerjen e detyrave të ngarkuara, punonjësit e policisë përdorin armën në bazë të dispozitave ligjore.

Neni 34

Punonjësit e policisë së rendit kanë të drejtë të vendosin gjoba në vend, për shkeljet e mëposhtëme që nuk përbëjnë vepër penale:

1. Kur shtetasit, pa shkaqe të përligjura, nuk pranojnë tu japin ndihme punonjësve të policisë së rendit, për të kryer detyrat me mjete transporti a ndërlidhjeje.
2. Kur shtetasit nuk pranojnë të paraqiten në organet e policisë, pasi janë thirur më parë sipas nenit 24.
3. Kur shtetasit shqiptarë, të huaj ose persona pa shtetesi nuk pranojnë të paraqesin dokumentet e identitetit.
4. Kur personi bën thirrje për mosbindje ndaj kërkesave të ligjshme të punonjësve ose punonjësve të policisë së rendit.
5. Ndaj personave që prekin me fjalë e gjeste nderin e dinjitetin e punonjësve të policisë së rendit.

Gjoba në vend jepet në masën 10-300 lekë nga punonjësi i policisë së rendit. Kompetencat për dhënien e gjobave përcaktohen nga ministri i Rendit Publik. Punonjësi i policisë së rendit përfiton 10 për qind të gjobës së dhënë. Kur gjoba konsiderohet e kundërligjshme, dëmshpërblehet nga punonjësi i policisë që e ka vënë.

Kundërvajtësi mund të ankohet kundër vendimit të gjobës brenda 5 ditëve tek shefi i policisë së rendit të rrethit ose rajonit, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

KREU V

PRANIMI, KUALIFIKIMI, TRAJTIMI DHE SHËRBIMI NË POLICINË E RENDIT

Neni 35

Policia e rendit përbehet nga efektivit oficer, nënoficer e polic.

Neni 36

Ne organet e policisë së rendit pranohen për police, mbi baza vullnetare dhe me kontrate,

shtetasit shqiptare që plotësojnë këto kërkesa:

- të kenë përfunduar arsimin e mesëm;
- të kenë kryer shërbimin ushtarak;
- të mos jenë të denuar penalisht;
- të plotësojnë kushtet e konkursit për policët;
- të plotësojnë kushtet shëndetësore, fizike dhe gjatësinë mbi 1.70 cm, si dhe të jenë të moshës deri në 26 vjeç;
- të kenë figurë të pastër morale.

Neni 37

Nënoficerë titullohen punonjësit e policisë së rendit, që kanë kryer shkollën e policisë, kanë rezultate pozitive në detyrat e ngarkuara, kanë mbi 2 vjet stazh shërbimi në polici dhe janë me moshë deri në 35 vjeç.

Neni 38

Oficerë të policisë së rendit titullohen gjithë personat që mbarojnë shkollën e lartë të profilit të policisë ose personat të tjerë që kanë mbaruar arsimin e lartë në profil tjetër dhe që i nënshtrohen një kursi special kualifikimi. Ata duhet të jenë të moshës deri në 30 vjeç.

Oficerëve të policisë së rendit u lejohet të vazhdojnë kurs kualifikimi shkencor pasuniversitar, sipas fushave që cakton Ministria e Rendit Publik ose jashtë shtetit.

Oficeri, nënoficeri e polici u nënshtrohen programeve të aftësimit të mëtejshëm profesional, juridik e ushtarak në punë e sipër.

Neni 39

Në detyra të tjera drejtuese të policisë së rendit caktohen oficerë me stazh nga 5-10 vjet, sipas rëndësisë së funksionit që do të kryejnë.

Ngritja në funksion më të lartë e oficerit dhe e nënoficerit bëhet pas dhënies së provimit përkatës të specialitetit si dhe duke pasur parasysh punën konkrete e rezultatet e arritura.

Neni 40

Punonjësit e policisë së rendit transferohen: për nevoja punë, kur ndërshkohen për shkelje të disiplinës, me kërkesën e tyre dhe në raste kur ngrihen në përgjegjësi.

Neni 41

Për shkelje të disiplinës e për mangësi në kryerjen e detyrave oficeret, nënoficerët dhe policët e policisë së rendit ndërshkohen me masa sipas rregullores së disiplinës.

Punonjësit e policisë së rendit përgjigjen ligjërisht në rastet kur kryejnë detyra me kapërcim të ligjit.

Neni 42

Punonjësi i policisë së ruajtjes së rendit dënohet, në kushtet e rrethanave rënduese, kur për moskryerje të detyrës ose të indiferentizmit vijnë pasoja të rënda si vdekje, plagosje të rënda, vjedhje në përpjestime të mëdha, djegie e shkatërime të pasurisë.

Neni 43

Oficerët, nënoficerët dhe policët e policisë së rendit lirohen nga detyra në raste kur dënohen për vepra penale, kur kryejnë shkelje të rënda në detyrë dhe kur kanë mangësi të vazhdushme në kryerjen e detyrës.

Punonjësve të policisë, që lirohen nga detyra, u hiqet dokumenti i identitetit si ushtarak, arma, si dhe nuk u lejohet të mbajnë uniformë.

Neni 44

Vendimin për lirimin nga detyra të oficerëve, nënoficerëve dhe policëve e bën organi që i vendos në detyrë.

Oficerët kanë të drejtën e ankimit në komisionin përkatës të miratuar nga Ministri i Rendit, kurse nënoficerët e policisë dhe policët e rendit në komisionin e miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Vendimi i komisionit është i formës së prerë.

Neni 45

Eprorët sigurojnë dhe ndjekin zbatimin e vendimeve të marra e të urdhërave të dhëna dhe mbajnë përgjegjësi për pasojat.

Vartësit janë të detyruar të zbatojnë urdhërat e dhëna me përpikmëri e në afatin e caktuar, me përjashtim të rasteve kur urdhëri është dukshëm kriminal.

Neni 46

Kur punonjësi i policisë së rendit bie duke kryer detyrën, familjes së tij i jepet pension familjar në masën e pagës së plotë që ai ka patur. Kohëvazhdimi i pensionit, rastet dhe personat që e përfitojnë atë, caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 47

Punonjësit e policisë së rendit përfitojnë të gjitha të drejtat, që përcaktohen me ligjin për statusin e ushtarakut dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 48

Paga e punonjësi të policisë së rendit të jetë me e lartë së paga e punëtorit të sektorit të vështirë të ekonomisë. Atij i paguhen orët e shërbimit suplementar dhe një orë më shumë për shërbimin e kryer natën.

Neni 49

Punonjësit e policisë që kryejnë vepra penale, dënimin me heqje të lirisë e kryejnë në reparte riedukimi të veçanta, sipas një rregjimi që caktohet nga ministri i Drejtësisë dhe ai i Rëndit Publik.

KREU VI

PAJISJET TEKNIKE NË SHËRBIMET E POLICISË SË RENDIT

Neni 50

Organet lokale të pushtetit detyrohen të vënë në dispozicion të organeve të policisë së rendit mjedise të përshtatshme për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

Neni 51

Organet e policisë së rendit, për përmbushjen e detyrave të tyre, pajisen me mjete e materiale teknike, sipas detyrave që kryejnë.

Ato mund të blejnë materiale e pajisje të veçanta dhe drejtëpërsëdrejt në tregun e brendshëm a të jashtëm.

Neni 52

Ndërmarrjet e transportit, për nevojat e policisë që shërbejnë në transport, sigurojnë vetë vende të përshtatshme, pajisje, mjete transporti, mjete nderlidhje e mjete të tjera teknike dhe marrin përsipër shpenzimet për mirëmbajtjen e tyre.

Neni 53

Organet e policisë së rendit sigurojnë, kundrejt pagesës, objekte të personave juridikë e fizikë, në bazë të kushteve që përcaktohen në kontratën e lidhur me ta.

Neni 54

Ligji nr.7045, datë 2.7.1986 "Për policinë popullore", shfuqizohen.

Neni 55

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
RAMIZ ALIA